



Prishtinë: 30.03.2011

Kodi i ZRRE-së: V_347_2011

Nr.i Referencës: ZRRE/DMK_V_543_01_11

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
4. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
5. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_543_01_11**;
6. Apeli i KEK-ut me datë 23.02.2011;

Në mbledhjen e mbajtur më 30 mars 2011 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET apeli i KEK-ut për ankesën e konsumatorit Milaim Bllaca (shifra e konsumatorit DPZ – 60157) nga Theranda, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së me datë 26.04.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 22.01.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 28.05.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 5373098 dhe kanë vendosur për matje njehsorin e vet elektrik nr. 7708347.

Provë: Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik datë 28.05.2008

- Me datë 05.07.2008 punëtorët e qendrës së kalibrimin kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 5373098, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllombat) shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme qelqi i njehsorit është i krisur, për rreth qelqit nga ana e epërme është futur shiriti filmik dhe është penguar puna e diskut.

Provë: Procesverbali me nr. 29/5 i datës 05.07.2008

- Me datë 08.08.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për shqyrtimin e njehsorëve elektrik kanë shqyrtuar njehsorin elektrik nr. 5373098 me ç'rast kanë konstatuar se njehsori elektrik është brenda kufijve të lejuar të matjes.

Provë: Protokoli mbi shqyrtimin e njehsorit elektrik nr. 003351 i datës 08.08.2008

- Me datë 04.11.2008 zyrtarët e autorizuar të KEK-ut kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë regjistrimin e të dhënave teknike të pikës matëse.

Provë: Procesverbali i KEK-ut me nr. 215562 të datës 04.11.2008



- Me datë 19.12.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPZ08HP04544 në vlerë prej 2,746.20 €.
Provë: Fatura DPZ08HP04544 e datës 19.12.2008
- Me datë 22.01.2009 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.
Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK, datë 22.01.2009
- Me datë 22.01.2010 Departamenti për Konsumator në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesverbalin e kontrollës dhe kalibrimit.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 22.01.2010
- Me datë 19.04.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 10.01.2011 DMK ka lëshuar vendimin nr. ZRRE/DMK_V_543_01_11, dhe duke u bazuar në analizat e bëra ka aprovuar ankesën e konsumatorit dhe ka arritur në përfurnim se:
 1. KEK-u duhet të shkarkoj konsumatorin nga fatura e rikthimit të humbjeve DPZ08HP04544 të datës 19.12.2008 në vlerën 2,746.20 €

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK_V_543_01_11** dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi (KEK-u) nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë apelimin** KEK-ut për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK. Bordi i ZRRE-së ke vendosur që vendimi i DMK **ZRRE/DMK_V_543_01_11** të mbetet në fuqi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar

